

VENDIM
Nr.629, datë 27.8.2004

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.315, DATË 24.4.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR DHËNIEN ME QIRA TË PASURIVE TË NDËRMARRJEVE,
SHOQËRIVE DHE INSTITUCIONEVE SHTETËRORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 22 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.315, datë 24.4.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja "b" e pikës 1 të kapitullit III ndryshohet si më poshtë vijon:

"b) - Për zyra, dyqane "Duty Free", agjenci shërbimi dhe bar-bufe në aeroporte e dogana, jo më pak se 2500 lekë/m² në muaj.

- Për zyra, agjenci shërbimi dhe bar-bufe në porte, jo më pak se 1000 lekë/m² në muaj."

2. Pika 4 e kapitullit III ndryshohet si më poshtë vijon:

"4. Për truallin e lirë, funksional, (jo në ndërtesë) çmimi dysheme i qirasë mujore është 20 për qind e çmimit dysheme të qirasë mujore, të përcaktuar në pikën 1 të kapitullit III të vendimit."

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano